

V E N D I M
Nr. 479, datë 31.8.2000

**PËR PËRGATITJEN DHE REALIZIMIN E KONTRATËS SË KONCENSIONIT,
PËR NDËRTIMIN E TERMINALIT TË RI TË PASAGJERËVE, NË AEROPORTIN
E RINASIT**

(Ndryshuar me VKM nr. 562, datë 23.10.2000; nr. 603, datë 2.11.2001)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995, “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të neneve 21 dhe 29, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 7, të ligjit 8554, datë 10.12.1999, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2000”, të ligjit nr.7638, datë 11.11.1992, “Për shoqërinë tregtare”, dhe të neneve 5, 17, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe të ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurës së tenderimit, për ndërtimin e terminalit të ri të pasagjerëve në aeroportin e Rinasit, me koncension të formës BOOT.

Objekt i koncensionit të jenë edhe elementët e tjerë infrastrukturorë, shërbimet aeroportuale dhe joaeroportuale, sipas përcaktimit të masterplanit të zhvillimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Rinasit.

2. Procedura e përzgjedhjes së investitorit të jetë tenderi i hapur, ndërkombëtar, me dy faza (faza e parë: parakualifikimi).

3. Realizimi i procedurave për ndërtimin e terminalit të ri të pasagjerëve dhe elementëve të tjerë infrastrukturorë, shërbimeve aeroportuale dhe joaeroportuale në aeroportin e Rinasit, me koncension të formës BOOT, të bëhet me konsulencë ndërkombëtare.

4. Lejohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit në emër të OSHA të prokurojnë fondin limit prej 43 500 000 (dyzetetë milionë e pesëqind mijë) lekësh, me procedurën “Kërkesë për kuotim”, me shoqëritë konsulente, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. *Fondi prej 43 500 000 lekësh të përballohet nga fitimi i pritshëm për vitin 2000 i “Albtransport” sh.a.*

6. *Shfuqizuar.*

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LISTA E SHOQËRIVE KONSULENTE

ABM AMRO

BANCA D'INTERNAZIONALE MOBILIARE (IMI)

CREDITANSALT INVESTMENT BANK

CREDIT SUISSE FIRST BOSTON

LAZARD VITALE BORGHESI&C

MORGAN STANLEY

NATIONAL BANK OF GREECE

SBC PARBURG DILLON REED

DELOITTE&TOUCHE

PRICE WATERHOUSE COOPERS

PARSA-PARBUR SMITH ASSOCIATES

EUROPEAN INVESTMENT BANK